UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË

Nr. Prot. 2875 Dt. 17.11.2026

Duke u bazuar në nenin 24 të Statutit të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 13.11.2026, vendosi që të shpall:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve themelore bachelor dhe studimet master të Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë, për vitin akademik 2025/2026.

I. Bursa universitare iu ndahet studentëve të studimeve bachelor dhe studimeve master.

II. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët, të cilët i plotësojnë këto kushte:

1. të jenë student të rregullt të Universitetit të Mitrovicës;
2. të jenë student të vitit të dytë e më lart;
3. të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
4. të kenë dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak përkatës të studimeve në afatin e shtatorit;
5. të kenë notë mesatare të studimeve më së paku:

- 8.0 (tetë pikë zero) — për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin e Gjeoshkencave, Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;
- 9.00 (nëntë pikë zero) — për studentët e studimeve bachelor në Fakultetin Juridik, Ekonomik dhe të Edukimit;
- 8.5 (tetë pikë pesë) — për studentët e studimeve master në Fakultetin e Gjeoshkencave; Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore dhe Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike;

III. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika II e këtij vendimi duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Dëshminë e aplikimit për bursë në SMU
- Vërtetimi për statusin e studentit (lëshohet nga Fakulteti)
- Pasqyra e notave (lëshohet nga Fakulteti)
- Deklarata nën betim e nënshkruar.

IV. Shuma e mjeteve që do të ndahet për bursa universitare caktohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues.

Studentët bursistë do ta gëzojnë këtë të drejtë për vitin akademik 2025/2026.

Afati i aplikimit zgjat prej datës 18.11.2026 deri më 25.11.2026.
Dorëzimi i dokumentacionit bëhet në fakultetet përkatëse.

Shkarkoni Fletëparaqitjen nga raporti i aplikimit në SMU
Shkarkoni deklaratën në betim

Rr. Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
http://www.umib.net; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1